REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.4905/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, nga gjyqtari Nehat Idrizi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.A., me seli në Prishtinë, Rr. "Nëna Terezë" nr. 36, kundër debitorit R. N. nga Peja, lidhur me çështjen përmbarimore, për borxh, duke vendosur sipas ankesës së kreditores e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, Ep.nr.192/19, i datës 12.03.2020, me datë 15.06.2021, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditores: Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a., me seli në Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" nr. 36, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, Ep.nr.192/19, i datës 12.03.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, Ep.nr.192/19 i datës 12.03.2020, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të pranohet si i bazuar prapësimi i debitorit R. N. nga Peja, i parashtruar kundër urdhrit të Përmbaruesit Privat Z.B. në Pejë P.nr. 1160/18 i datës 19.12.2018. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të shfuqizohet urdhri përmbarimor i Përmbaruesit Privat Zija Bala në Pejë, P.nr. 1160/18 i datës 19.12.2018.

Kundër këtij aktvendimi kreditorja brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktvendimin e goditur për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të: aprovohet ankesa e kreditores dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim ose të prishet aktvendimi i atakuar dhe çështja ti kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe në rivendosje, duke i evituar lëshimet e cekura më lartë si në ankesë dhe detyrohet debitori ti paguaj në emër të shpenzimit të energjisë elektrike shumën prej 187,10 €, të pa paguar, për periudhën 05.12.2011 deri më 20.03.2013. Si dhe ti bartë shpenzimet për ankesë në lartësi sipas UA 01/2017 për taksat gjyqësore.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), ka gjetur se:

Ankesa e autorizuarit të kreditores është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditorja në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste me nr. DPE – 9030665, e datës 18.12.2018, ka paraqitur propozim për përmbarim me datë 19.12.2018, ndaj debitorit për shumën e detyrimit në lartësi prej 187.10 €, për konsumimin e energjisë elektrike të krijuar nga data 05.12.2011 deri me datën 20.03.2013, në afat prej 7 ditësh prej ditës së pranimit të këtij vendimi, me kamatë 8% nga dita e kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive të borxhit.

Përmbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditores të datës 19.12.2018, ka nxjerrë Urdhrin Përmbarimor me shenjë P.nr.1160/18, i datës 19.12.2018, me të cilën e ka lejuar përmbarimin sipas Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste me nr. DPE- 9030665, e datës 18.12.2018, duke e pranuar si dokument të besueshëm, e cila i plotëson kushtet për ta lejuar përmbarimin.

Kundër urdhrit përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 18.01 .2018, duke propozuar që të: Aprovohet prapësimi i debitorit duke refuzuar propozimin për përmbarim sepse kartela e konsumatorit përmban borxhin i cili me dispozitën ligjore të nenit 360 të LMD-së është parashkruar.

Me përgjigje në prapësim të datës 30.01.2019, kreditorja ka theksuar se: bazuar në argumentet e mësipërme, kundërshtimi i debitorit është i paargumentuar dhe i pabazuar, andaj ka propozuar që të mbetet në fuqi Urdhri i Përmbaruesit Privat për caktimin e përmbarimit dhe nëse gjykata kompetente edhe pas kësaj përgjigje në prapësim nga kreditorja nuk është qartësuar për validitetin dhe domethënien e përgjigjes së kreditorit kanë propozuar që në kuptim të nenit 73 të LPP-së, të caktohet seancë publike në këtë çështje.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimit, me aktvendimin e atakuar Ep.nr. 192/19, i datës 12.03.2020, ka vendos që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, duke e shfuqizuar Urdhrin Përmbarimor, P.nr.1160/18, i datës 19.12.2018, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori dhe personi S. H. për borxhin e kërkuar si në propozim, me datën 29.08.2016 kanë lidhur kontratë nr. 36342 për pagesën e këtij borxhi me anë të kësteve dhe atë në shumë prej 169,25 €, duke u falur borxhi nga kreditori në shumë prej 133.85 € me qëllim të përfitimit nga falja e borxheve sipas Ligjit nr. 05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike.

Andaj meqenëse ndaj debitori ndaj të cilit kërkohet borxhi në rastin konkret nuk e ka nënshkruar kontratën e cekur më lartë, gjykata ka gjetur se prapësimi i debitorit është i bazuar, ngase me

dispozitën ligjore të nenit 368 par. 1 të LMD-së, është përcaktuar se: "parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit. Ka shtuar se gjykata ka konstatuar se në këtë rast kemi të bëjmë me parashkrimin e borxhit të kërkuar nga ana e kreditorit, ngase borxhi ndaj debitorit kërkohet për periudhën kohore nga data 05.12.2011 deri me datën 20.03.2013, ndërsa propozimi i kreditorit për përmbarim është parashtruar me datë 19.12.2018 pas kalimit të afatit një vjeçar të përshkrimit siç kërkohet me dispozitën ligjore të nenit 378 të LMD-së, të vitit 1978 ish RSFJ-së, i aplikueshëm deri me datën 31.12.2012 dhe dispozitave ligjore të nenit 360 par. 1 pika 1.1 dhe par. 2 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077), i cili përcakton: se kërkesat të cilat parashkruhen pas një viti janë kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake, ndërsa afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ju ka referuar neneve 19 paragraf 6, 43 paragraf 4 dhe 73 paragraf 1 të LPP-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar dhe konstatuar gjendja faktike dhe aktvendimi i atakuar nuk përmban as shkelje të dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbarimore dhe Ligjit të Procedurës Kontestimore sipas pretendimeve ankimore të kreditores përmes ankesës së paraqitur.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike përmbarimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë, duke u mbështetur në provat e administruara të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht, duke zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

Pretendimi ankimor i kreditores se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbarimore pa specifikuar shkeljet e pretenduara, me arsyetimin se ekstrakti në bazë të cilës është lejuar përmbarimi, është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarim dhe se debitori me datë 29.08.2016 në mënyrë të rregullt e ka pranuar borxhin në deklaratën me nr. 36342 të cilën edhe e ka nënshkruar, përfshirë edhe kontratën për pagesën e borxhit, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pabazuar, për shkak se me nenin 21 të LPP-së, përcaktohet se " Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë te dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se më këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër ". Në kuptim të kësaj dispozite nënkuptojmë se organi përmbarues duhet të vendos brenda kufijve të titullit përmbarues, ndërsa me rastin e vendosjes për

prapësimin e debitorit, gjykata është dashur të vlerësoj se a ekziston ndonjëri nga shkaqet ligjore të parapara me nenin 71 të LPP-së, dhe se arsyetimi i gjykatës si në arsyetimin e aktvendimit të atakuar në këtë fazë të procedurës, është i drejtë dhe i bazuar në dispozitat e LPP-së.

Me nenin 29 paragrafi 1 pika 1.2 e LPP-së, përcaktohet se: " Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në to holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: ... ekstraktet e verifikuara nga librat afariste ". Në këtë rast në shkresat e lëndës si provë materiale përveç tjerash gjendet ekstrakti i verifikuar nga librat afariste nr. DPE-9030665 i datës 18.12.2018. Mirëpo në këtë rast nga shikimi i ekstraktit lidhur me pasqyrën e obligimeve dhe pagesave nga ana e kreditores dhe provat e tjera vërtetohet se debitori nuk ka nënshkruar kontratën për pagesën e borxhit dhe deklaratën për dakordimin e borxhit.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, se me rastin e pranimit të prapësimit të palës debitore të paraqitur kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, P.nr. 1160/18 i datës 19.12.2018, sepse gjykata i ka vlerësuar rrethanat e lartcekura në kuadër të provave që i ka pasur në dispozicion në momentin e vendosjes sipas prapësimit.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsyeje se:

Me nenin 378 paragraf 1, pika 1 të LMD-së, (Ligji i RSFJ-së, datës 30 Mars 1978), përcaktohet se: Parashkruhen për një vjet: " Kërkesat e kompensimit për livrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit, për shërbimet e spastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi, respektivisht shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake ".

Me nenin 387 paragraf 1 të këtij ligji përcaktohet se: " Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pohon borxhin, ndërsa me paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se: " Pohimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm duke i dhënë deklaratë kreditorit, por edhe në mënyrë indirekte, siç janë dhënia e kisteve, pagimi i kamatave, dhënia e sigurimit".

Me nenin 388 të këtij ligji përcaktohet se: " Parashkrimi ndërpritet me ngritjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent, me qëllim përcaktimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës".

Me nenin 392 paragraf 1 të këtij ligji përcaktohet se: " Pas ndërprerjes së parashkrimit fillon të rrjedh përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim", ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se: " Parashkrimi i ndërprerë me anë të pohimit nga ana e debitorit fillon të rrjedh përsëri nga pohimi".

Me nenin 360 paragraf 1, pika 1.1 të LMD-së, (Ligji nr. 04/L-077), përcaktohet se: "Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: Kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake", ndërsa me paragrafin 2 të po këtij

neni, përcaktohet se: " Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë".

Me nenin 368 paragraf 1 të këtij ligji përcaktohet se: " Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin", ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: " Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthorë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit".

Me nenin 369 të këtij ligji përcaktohet se: " Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës".

Me nenin 373 paragraf 1 të këtij ligji, përcaktohet se: " Pas ndërprerjes së parashkrimi fillon të rrjedh përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim", ndërsa me paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se: " Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimit (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedh përsëri nga pranimi (pohimi)".

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallë së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale dhe ka vërtetuar se e drejta e kreditorit për të kërkuar pagimin e borxhit ndaj debitorit është parashkruar, për arsye se kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit - borxhit për periudhën kohore me datë 05.12.2011 - 20.03.2013, ndërsa propozimi është paraqitur të Përmbaruesi privat me datë 19.12.2018, e nga kjo rezulton se nga data 20.03.2013, e deri në paraqitjen e propozimit tek përmbaruesi privat kanë kaluar me shumë se 5 vite, çka do të thotë se kërkesa e kreditorit për të kërkuar përmbushjen e detyrimit të lartcekur është parashkruar, për faktin se në këtë rast kontrata për pagesën e borxhit dhe deklarata mbi dakordimin e borxhit e datës 29.08.2016 nuk është lidhur e as nënshkruar nga debitori R. N., por nga një person tjetër gjegjësisht S. H. e çka do të thotë se në këtë rast nuk kemi pohim të borxhit nga ana e debitorit dhe as ndërprerje të parashkrimit.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.4905/20, me datë 15.06.2021

Gjyqtari
Nehat Idrizi